

Instituti për Studime të Avancuara GAP

Peja – Raporti komunal

Tetor 2009

Peja në shifra

Popullsia	Gjithsej	125752
	Shqiptarë	90%
	Boshnjak	3.5%
	Të tjerë	6.5%
Gjeografia	Sipërfaqja (km ²)	603
	Numri i fshatrave	
Shkollimi	Pa shkollë/fillore e papërfunduar	12.55%
	Fillore/e mesme e papërfunduar	33.35%
	E mesme	40.22%
	Shkollë e lartë	13.14%
	Universitet	0.73%
	Nr. i nxënësve	23442
	Nr. i mësimdhënësve	1286
	Nr. i shkollave të mesme (me paralele të ndara)	5
	Nr. i shkollave fillore (me paralele të ndara)	42
	Nr. i çerdheve	1
	Shëndetësia	Spital
Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare		1
Qendra të Mjekësisë Familjare dhe punkte shëndetësore		24
Nr. i mjekëve		105
Papunësia	Gjithsej	34.90%
	Meshkuj	27.60%
	Femra	49.06%
Të punësuar	Fuqi punëtore (15-64 vjet)	76,709
	Të punësuar në sektorin publik komunal	2,322
Buxheti 2009	Gjithsej (Euro)	12,638,499
	Të hyrat vetanake të planifikuara (Euro)	1,880,317
	Të hyrat tjera (Euro)	10,758,182
Shpenzimet e realizuara (2008)¹	Gjithsej (Euro)	10,255,329 (86%)
	Shpenzimet kapitale (Euro)	2,082,965 (83%)
	Shpenzimet tjera (Euro)	8,172,364 (97%)
Rezultatet e zgjedhjeve lokale 2007	AAK	22.91%
	LDK	16.53%
	LDD	15.38%
	PDK	13.74%
	ORA	11.50%
	AKR	9.20%
	IRDK	1.75%
	SDA	1.69%
Bosnjacka Inicijativa	1.39%	

¹ Në kllapa ndodhen përqindjet e shpenzimit të buxhetit që ka qenë në dispozicion.

	Tjera	5.93%
Kryetarët e Komunës 2000-2009	2000-2002: Ali Lajçi (LDK) 2002-2007: Ali Lajçi (LDK) 2007-2009: Ali Berisha (AAK)	

Shkurt për Pejën

Peja njihet si një ndër qytetet më të vjetra në Kosovë dhe përbën një ndër qytetet më të bukura dhe më të pasura me potenciale kulturo-historike dhe bukuri të rralla natyrore. Komuna e Pejës përfshin një hapësirë prej 603km², që e bën atë komunën e tretë më të madhe në Kosovë për nga sipërfaqja. Komuna e Pejës shtrihet në perëndim të Kosovës, kurse qyteti i Pejës shtrihet përgjatë dy anëve të lumit Lumbardhë i cili buron në Bjeshkët e Rugovës dhe ka një gjatësi prej 63km deri në lidhje me lumin e Drinit të Bardhë. Qyteti me rrethinë ka 125,752 banorë. Në dekadën e fundit ka një koncentrim të madh të popullsisë në qytet për shkak të kushteve më të mira për të jetuar dhe për tu punësuar. Popullata është e përzier me shqiptarët shumicë, si dhe komuniteteve tjera si serbët, malazezët, boshnjakët, romët etj. Historia e vjetër e qytetit, potencialet dhe pasuritë e shumta kulturore dhe ato natyrore me të cilat disponon komuna e Pejës si dhe pozita gjeografike dhe lidhjet rrugore që i ka me shtetet tjera, ka mundësuar që Peja të ketë një zhvillimin të hershëm të turizmit.

Problemet aktuale

Qytetarët e Komunës së Pejës ballafaqohen me disa probleme të përditshme ku ndër të tjera veçojmë:

- Siguria në shkolla
- Prerja e pyjeve
- Ndotja e Lumëbardhit
- Ndriçimi publik
- Problemet në komunikacion

Një problem që shqetëson qytetarët e Pejës e në veçanti prindërit është **siguria në shkolla**. Ky është një problem evident në komunën e Pejës. Përleshjet mes nxënësve, e madje edhe fërkimet në raport nxënës-profesor janë pothuajse ngjarje të përditshme, e sidomos në shkollat e mesme: shkollën e mesme ekonomike, shkollën e mesme teknike dhe gjimnazin. Nxënësit janë të obliguar të paguajnë sigurimin privat në shumën prej 5€/muaj për t'i siguruar shkollat dhe nxënësit. Në shumë shkolla shpesh edhe shërbimi policor duhet të ndërvejoj siç është rasti në shkollën e mesme të gjimnazit. Disa thonë se kjo dukuri është rritur shumë si pasojë e rritjes së numrit të nxënësve, përderisa objektet shkollorë nuk janë zgjeruar. Gjimnazi në të shkuarën ka pasur 1,200-1,500 nxënës ndërsa tani numri i tyre sillet në mbi 2,200. Formimi i tri klasave në muajin tetor (1 muaj pas fillimit të vitit akademik shkollor), nga nxënësit të cilat nuk kanë mundur të kalojnë testin e gjysmë-maturës (rreth 150) duket edhe më shqetësuese për banorët e Pejës, meqenëse sipas tyre të gjithë ata individë që kanë një historik jo të mirë janë mbledhur në 3 klasa. Në raportin "Llogaridhënia e institucioneve demokratike ndaj shoqërisë në Kosovë" për komunën e Pejës arsimi zë një vend shumë shqetësues, ku ndër të tjera thuhet se pasiguria në proceset

shkollore vjen edhe si rezultat i menaxhimit të dobët të këtyre shkollave, dhe profesorëve jo-profesional.

Komuna e Pejës shquhet për bukuri të rralla malore, por **prerja e pyjeve** rrezikon këtë bukuri natyrore. Preja e pyjeve në Bjeshkët e Rugovës është një dukuri që nuk ka të ndalur dhe i shqetëson shumë qytetarët. Pakujdesia e madhe gjatë prerjes së këtyre bjeshkëve gjatë muajve të verës shpesh ka shkaktuar edhe zjarre të mëdha, përderisa institucionet nuk janë paraqitur shumë të vëmendshëm ndaj këtij fenomeni. Ato vazhdojnë të lëshojnë leje për kompani të ndryshme për t'i pastruar pyjet të cilat pastaj e keqpërdorin këtë leje dhe bëjnë prerjen e tyre. Në kohët e presionit mediatik kjo dukuri "ndalon" për një kohë, por sapo të përqendrohet vëmendja e medieve në probleme tjera, prerja e pyjeve sërish vazhdon. Përpos degradimit të bjeshkëve, prerja e pyjeve po mundëson rrëshqitjen e dheut në fshatrat rreth bjeshkëve duke rrezikuar jetën e këtyre banorëve. Edhe pse shumë organizata joqeveritare, e sidomos ajo "Era" merren aktivisht me ngritjen e vetëdijes tek qytetarët dhe bëjnë në presion në Institucionet komunale, mirëpo problemi qëndron në përzjerjen e kompetencave në mes nivelit lokal dhe atij qendror. Komuna hedh fajin tek Agjencioni për Menaxhimin e Pyjeve të Kosovës dhe Ligjin e Pyjeve, i cili i jep kompetenca për menaxhimin e pyjeve Agjencionit Pyjor, i cili është agjencion i nivelit qendror. Sipas statistikave të policisë, vetëm gjatë vitit 2008 janë evidentuar 1159 raste të prerjes ilegale të pyjeve. Këtu nuk përfshihen shifrat me të cilat posedon Agjencioni i Pyjeve, dhe shumë raste që mbeten të pa evidentuara. Përveç prerjes së pyjeve, në Bjeshkët e Rugovës ka edhe ndërtime ilegale, për të cilat komuna nuk ka ndërmarr asgjë. Tani me draftligjin e ri për pyjet, kompetencat për menaxhimin e pyjeve do të kalohen komunave.

Lumëbardhi. Problem shumë shqetësues për banorët e komunës së Pejës është edhe shtrati i lumit Lumëbardhi, problem ky që fillon që nga Patrikana e deri në Komunën e Klinës. Nga lumi në mënyrë të pakontrolluar nxjerrët zhavorri i cili ka deformuar shtratin e lumit, janë hapur një numër i madh gropash në të cilat gjatë verës mbledhet uji, duke e lënë shtratin e lumit pa ujë. Për më tepër në këtë lum derdhen edhe ujërat e zeza dhe kështu Lumëbardhi është shndërruar në një lum kundërmues gjatë sezonit veror. Gërryerja e shtratit të lumit, i cili ka shkaktuar deformimin e tij, paraqet edhe një problem tjetër – vërshimet të cilat bëhen gjatë kohërave me shi, sidomos në zonën e Dardania III, pjesë kjo e cila lidhet me Gorazhdecin; ndërsa tokat bujqësore të cilat përmblyten nga vërshimet janë ato të Kyqykut dhe Zahazhit. Disa kompani janë pajisur me leje për marrjen e zhavorrit nga shtrati i lumit me kusht të mirëmbajtjes së lumit nga mbeturinat, por ato nuk janë aspak të kujdesshme dhe nuk u përmbahen obligimeve. Problem tjetër i disa zonave përgjatë të cilave kalon Lumëbardhi e gjithashtu edhe përroskave është hedhja e pakontrolluar e mbeturinave, e sidomos ato që i hedhin mish-shitësit. Qytetarët kërkojnë më shumë nga komuna, sidomos me punën e Inspektorëve të ambientit (që në komunën e Pejës janë vetëm 2), por gjithashtu duhet bërë më shumë edhe në ngritjen e vetëdijesimit të vetë qytetarëve, të cilët nuk janë të vetëdijshëm që mos-kujdesi për Lumëbardhin dhe përroskat hap rrugë për përhapjen e epidemive të ndryshme.

Problem tjetër për banorët e qytetit është edhe **ndriçimi publik**. Vetëm qendra është ajo që ka ndriçimin publik, ndërsa shumë rrugë në qytetin e Pejës janë të errëta. Përfaqësuesit e Qendrës Rinore shprehën se rruga tek spitali gjithashtu është pajisur me shtyllat elektrike por ato ndodh që me javë të tëra nuk funksionalizohen. Banorët e komunës së Pejës janë shumë të shqetësuar për këtë fakt e sidomos për nxënësit që

kanë mësim gjatë orëve të vona të pasdites, dhe shumë prej tyre besojnë se problemet e shumta të përleshjeve vjen edhe si pasojë e territ nëpër rrugë, e cila i bënë shumë banorë të këtyre anëve të bartin mjete për vetë mbrojtje.

Përderisa numri i banorëve të qytetit vazhdon të rritet, **problemët në komunikacion** po rriten gjithashtu. Problem e evident në komunën e Pejës është mungesa e vend-parkingjeve. Automjetet parkohen kudo, e sidomos nëpër trotuare duke iu pamundësuar këmbësorëve kalimin nëpër tretuar, për më tepër automjetet në komunikacion ngasin automjetet e tyre shpesh në shpejtësi më të lartë sesa është e lejuar dhe si të tilla aksidentet janë të shpeshta. Kjo dukuri është shumë shqetësuese sidomos pranë shkollave fillore, kur nxënësit duhet të ecin nëpër rrugë; siç është rasti me Shkollën Fillore të Raukshiqit. Vitin e kaluar (2008) kanë ndodhur 2-3 aksidente me nxënësit e shkollave fillore si pasojë mungesës së trotuareve. Edhe pse në disa shkolla janë krijuar kabine të sigurisë, në të cilat janë mbajtur trajnime të ndryshme, problemet e llojit të tillë janë ende evidente.

Premtimet dhe puna e Kryetarit të Komunës

Që nga viti 2000, Peja ishte udhëhequr nga Ali Lajçi dhe subjekti i tij politik i LDK. Në zgjedhjet e nëntorit 2007, fitues doli partia e AAK-së, përderisa për kryetar të Pejës u zgjodh Ali Berisha. Në raundin e parë të zgjedhjeve Ali Berisha fitoi 8.203 vota apo 23% të votave, dhe këto vota ia mundësuan që të konkurroj edhe në zgjedhjet e balotazhit ku për kundërkandidat kishte Gazmend Muhaxherin e ORA's. Ali Berisha i fitoi zgjedhjet e balotazhit me 17.969 vota apo 67.9% dhe kështu qeverisi komunën për dy vitet e ardhshme.

Në përgjithësi Ali Berisha nuk ka arritur t'i realizoj të gjitha premtimet e dhëna gjatë fushatës para zgjedhore të vitit 2007. Një nga premtimet e tij ka qenë se do ta shtyj përpara projektin për ndërtimin e Parkut Nacional të Rugovës bashkë me ndërtimin e teleferikut. Padyshim ky projekt ambicioz ka një kosto tejet të lartë, prandaj edhe nuk është bëtë asgjë për realizimin e këtij projekti. Të vetmin hap që ka marrë komuna është hartimi i një plani për zhvillimin e turizmit në bjeshkët e Rugovës. Berisha gjithashtu ka dështuar të iu siguroj zjarrfikësve kushte më të mira pune. Ata edhe më tutje janë të stacionuar në një objekt të vjetër në qendër të qytetit, nga e cila ata nuk mund të intervenojnë edhe aq shpejt. Megjithatë, kryetari aktual ka arritur t'i përmbahet zotimit të tij se do t'u ndihmoj familjeve të dëshmorëve me strehim. Ai ka arritur të ndaj 200-300 toka/parcela për ndërtimin e banesave për këto familje. Por, meritë e kësaj qeverisje lokale është investimi i 40,000 eurove për ndriçim publik në qytet dhe 40.000 eurove të tjera për shënjestimin e rrugëve.

Një nga premtimet primare ishte edhe ofrimi i sigurisë më të madhe nëpër shkolla. Fatkeqësisht shumë pak është bërë në këtë drejtim, dhe nga sa edhe mund ta keni lexuar edhe më lart ky është problemi numër një aktual i qytetarëve të kësaj komune.

Tab.1. Premtimet dhe realizueshmëria e tyre

Premtimet	Realizimi
Angazhimi për të shtyj përpara projektin për Parkun Nacional të Rugovës dhe ndërtimin e teleferikut	Edhe pse zyrtarët komunal kanë hartuar një plan për zhvillimin e turizmit në bjeshkët e Rugovës të cilët fillimisht

	përfshijnë aktivizimin e bizneseve të vogla familjare – bujtinave dhe restoranteve, megjithatë nuk mund të thuhet se diçka konkrete është bërë për realizimin e këtij premtimi.
Do të angazhohet që zjarrfiksive të Pejës t'u sigurohen kushte më të mira për punë.	Nuk është realizuar
Do të ndërtoj infrastrukturën për zhvillim ekonomik përmes projektit për ngritjen e inkubatorit për bizneset e vogla dhe të mesme	Nuk është realizuar.
Rritja e sigurisë në shkolla.	Nuk është realizuar.
Sigurimi i transportit për mësimdhënësit	Komuna e Pejës ka formuar transportin urban me pagese me 2 linja të cilat priten të rriten në të ardhmen, mirëpo këto linja nuk ofrojnë mundësi udhëtimi pa pagesë për mësimdhënësit.

Zgjedhjet lokale në Pejë

Për shtatë vjet koma e Pejës është qeverisur nga LDK-ja. Në dy zgjedhjet e para, 2000 dhe 2002, lufta për të parin e komunës është zhvilluar kryesisht mes LDK-së dhe AAK-së. Në zgjedhjet e vitit 2000, LDK-ja dukshëm kishte fituar ndaj AAK-së. Nga 41 ulëse në KK të Pejës, LDK-ja kishte siguruar 28, kurse AAK vetëm 8. Kryetari i komunës Ali Lajçi në zgjedhjet e vitit 2002 fitoi përsëri, duke ia siguruar vetës edhe një mandat për 5 vitet e ardhshme. Edhe pse kësaj radhe LDK-ja kishte humbur një numër të konsiderueshëm të votuesve, ajo prapë arriti që të siguroj shumicën e ulëseve në KK, 19 sosh, apo 7 më shumë se AAK-ja. Ndarja e LDK-së në prag të zgjedhjeve 2007 pati pasoja edhe në këtë komunë. Në zgjedhjet e vitit 2007 Ali Berisha nga AAK fitoi 27% të votave që ia mundësuan atij të shkoj në balotazh për të fituar edhe atje kundër kandidatit nga ORA, Gazmend Muhexheri . Në këto zgjedhje ndodhi një ndarje më e barabartë e ulëseve të KK mes shumë partish. AAK fitoi 10 ulëse, LDK 7, PDK 6, LDD 5 e kështu me radhë. Tabela në vazhdim jep më shumë detaje rreth rrjedhave të zgjedhjeve në këtë komunë:

Tab.2. Partitë të cilat kanë arritur që të fitojnë ulëse në KK të Pejës.

Partia	Zgjedhjet 2000		Zgjedhjet 2002		Zgjedhjet 2007	
	Nr. i Votave	Ulëse në KK	Nr. i Votave	Ulëse në KK	Nr. i Votave	Ulëse në KK
PDK	4475	4	4143	4	4614	6
LDK	28352	28	20367	19	5549	7
AAK	7729	8	13470	12	7693	10
LDD	-	-	-	-	5162	6
AKR	-	-	-	-	3089	4
ORA	-	-	-	-	3861	5
IRDK	-	-	668	1	586	1

SDA	1239	1	-	-	566	1
Bošnjaka Inicijativa	-	-	-	-	465	1
VATAN	-	-	1097	1	-	-
BDIKHB	-	-	585	1	-	-
Riza Lluka	-	-	614	1	-	-
“Povratk”	-	-	1179	1	-	-
PSHDK	-	-	661	1	-	-

Edhe numri i votuesve ka shkuar duke rënë gjithnjë në tri palë zgjedhjet lokale. Përderisa në zgjedhjet e para lokale të vitit 2000 dalja e qytetarëve në zgjedhje ishte 45,155 apo 82.7%, në zgjedhjet e vitit 2002 numri i votuesve ra në 47.6%. Në vitin 2007 pjesëmarrja në votime kishte shënuar rënie edhe më të madhe, ku nga 73,191 qytetarë me të drejt vote, vetëm 33,572 kishin dalë në zgjedhje, apo 45.8%. Për zgjedhjet e nëntorit 2009, të drejtë vote kanë 89,153 qytetarë.

Tab.3. Statistikat e daljes së votuesve në zgjedhjet lokale në Pejë në tri palë zgjedhjet e gjertanishme

	2000	2002	2007
Votues me të drejtë vote	54601	79328	73191
Pjesëmarrja në votime	45155	45495	33572
Përqindja e daljes në votime	82.7%	57.35%	45.8%

Buxheti i Komunës

Komuna e Pejës nga viti 2003-2008 vazhdimisht ka pas një buxhet prej mbi 9 milion euro, me përjashtim të vitit 2007 kur buxheti total i kësaj komune kishte rënë në 8,517,046 euro. Sikurse edhe në çdo komunë tjetër, buxheti i komunës për vitin 2009 është rritur dukshëm. Gjatë vitit 2009, Peja kishte një buxhet prej 12,638,499 euro, që krahasuar me vitin 2008 është rritur për 2,811,671 euro. Viti 2009 gjithashtu dallon nga viti 2008 për nga shuma e investimeve kapitale. Përderisa në vitin 2008 janë shpenzuar 2,022,611 euro, në vitin 2009 janë shpenzuar 3,893,517 euro për investime kapitale, apo 1,870,906 euro më tepër.

Tab.4. Shpenzimet buxhetore sipas viteve dhe sipas linjave buxhetore

Viti	Rrogat dhe mëditjet	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencionet dhe transferet	Shpenzimet kapitale	Gjithsej
2009	€7,018,502	€1,037,922	€475,437	€213,121	€3,893,517	€12,638,499
2008	€5,930,600	€1,262,171	€398,325	€213,121	€2,022,611	€9,826,828
2007	€5,684,217	€1,133,275	€456,325	€224,983	€1,018,246	€8,517,046
2006	€5,642,366	€1,117,206	€379,174	€228,998	€2,093,197	€9,460,941
2005	€5,459,317	€993,022	€245,550	€178,000	€2,269,060	€9,144,949
2004	€5,644,251	€1,400,141	-	-	€2,139,108	€9,300,407
2003	€4,368,335	€1,884,391	-	-	€2,799,556	€9,393,532

Nga tabela e mësipërme mund të shohim se edhe buxheti për rroga dhe mëditje kryesisht ka shkuar duke u ngitur. Fundi dhe kreu i tabelës tregojnë më së miri ndryshimet në buxhet. Përderisa në vitin 2003 për rroga dhe mëditje ishin alokuar 4,368,335 euro, në vitin 2009 janë ndarë 7,018,502 për këto shërbime.

Investimet kapitale

Komuna e Pejës për vitin 2008 dhe 2009 nga buxheti i përgjithshëm ka ndarë mbi 5 milion euro për investime kapitale. Këto mjete kryesisht janë shfrytëzuar për këto projekte:

Tab.5.: Investimet kapitale në Pejë gjatë 2008 dhe 2009

Viti	Emri i projektit	Shuma e Projekteve
2008	Asfaltimi i rrugës "Ardian Krasniqi"	€124,558
2008	Asfaltimi i rrugës "Gjergj Fishta"	€138,850
2008	Ndërtimi i ujësjellësit në Raushiq-Zillopek-Zagerm	€295,141
2008	Asfaltimi i rrugës Vran. Brol. -Llug. Kos.	€114,080
2008	Rikonstruksioni i rrugës "Lekë Dukagjini"	€198,236
2008	Ndërtimi i kanalizimit në rrugën "Adem Jashari"	€119,812
2009	Ndërtimi i ujësjellësit Raushiq-Zillopek-Zagerm	€220,664
2009	Ndërtimi i ujësjellësit në lagjet Ter.-Zah.-Lesh	€200,000
2009	Ndërtimi i sheshit në qendrën e qytetit	€232,000
2009	QKMF	€180,388

Investime kapitale në tri vitet e ardhshme janë paraparë të rriten edhe më tej. Kuvendi Komunal i Pejës veç ka miratuar edhe Buxhetin e Komunës për vitet 2010-2012. Sipas vlerësimeve, në tri vitet në vazhdim, komuna e Pejës do të ketë në dispozicion një total prej 16,187,165 euro për investime kapitale, gjegjësisht 4,936,287euro për vitin 2010, 5,364,058 euro për vitin 2011, dhe 5,886,820 euro për vitin 2012.

Tab.6.: Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Pejës 2010-2012

Buxheti	2010	2011	2012
Buxheti i përgjithshëm në €	14,087,220	14,514,991	15,037,753
Të hyrat vetanake në €	2,391,751	2,467,680	2,538,863
Investimet kapitale në €	4,936,287	5,364,058	5,886,820

Nëse mund të japim një vlerësim të përafërt edhe për vitin 2013, duke u bazuar në vlerësimet buxhetore 2010-2012, atëherë mund të përfundojmë se kryetari i ardhshëm i komunës së Pejës për mandatin e tij qeverisës katërvjeçar do të ketë në dispozicion rreth 22 milion euro për investime kapitale.

Administrata komunale

Në komunën e Pejës të dhënat për vitin 2009 tregojnë se numri i të punësuarve në arsim, shëndetësi dhe administratë është 2,322. Krahasuar me vitin 2008, numri i

shërbyesve civil është rritur për 6 persona. Duke u mbështetur në vendimin e Qeverisë së Kosovës nr.10/46 (3 dhjetor 2008), e cila thotë se për 750 banorë duhet të ketë një punëtorë administrative, del se komuna e Pejës duhet të ketë 208 punëtorë administrativ, e jo 266 sa ka tani.

Tab.7. Numri i punonjësve në sektorin publik në Komunën e Pejës sipas viteve

Viti	Nr total i të punësuarve në arsim, shëndetësi dhe administratë
2009	2322 ▲
2008	2316 ▲
2007	2306
2006	2360 ▲
2005	2351
2004	2379 ▲
2003	2204 ■

Administrata komunale e Pejës, për herë të parë në Kosovë dhe e para në krahasim me komuna tjera, këtë vit ka filluar që të aplikoj projektin përmes së cilit qytetarët mund të kërkojnë përmes internetit dokumentet që u nevojiten dhe të paraqiten tek sportelet e komunës vetëm kur u nevojitet që të marrin dokumentin e printuar. Kjo ka lehtësuar shumë punën e qytetarëve në marrjen e dekomenteve. Edhe në vitin 2008, administrata komunale e Pejës ka qenë e para në krahasim me komunat tjera e cila ka aplikuar orar të zgjatur të punës në kohën kur mërgimtarët kanë qëndruar në Pejë. Vetëm në gjashtëmujorin e parë të 2009 në komunën e Pejës janë dorëzuar 9,928 kërkesa (në nëntë drejtori) dhe kjo komunë ka treguar efikasitetin më të lartë në Kosovë në krahasim me komunat tjera në zgjidhjen e kërkesave, pasi që vetëm brenda të njejtës periudhë i ka zgjidhur 96.6% prej tyre.

Komuna e Pejës dhe Ligji për Vetëqeverisje Lokale

Sa i përket përmbushjes së obligimeve që dalin nga Ligji për vetëqeverisje lokale, gjegjësisht numrit të mbledhje që duhet t'i mbaj Kuvendi Komunal gjatë një viti, Peja qëndron kryesisht mirë. Gjatë vitit 2008, KK ka mbajtur gjithsej 11 mbledhje, edhe pse ligji kërkon që minimum 10 mbledhje duhet mbajtur. Ndërkaq, Komiteti për Politikë dhe Financa, është takuar gjithsej 12 herë. Komiteti për politikë dhe financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik të komunës.

Ndërsa sa i përket tubimeve publike që komuna ka mbajtur me qytetarët, Komuna e Pejës gjatë vitit 2008 ka mbajtur 3 tubime publike, kurse për vitin 2009 nuk kemi të dhëna. Qasja në dokumentet zyrtare është e lehtë dhe konform Ligjit për qasje në dokumentet zyrtare. Edhe rregullorja komunale për transparencë e avancon qasjen në dokumente zyrtare. Shumica e dokumenteve lokale janë të publikuara edhe në faqen zyrtare të internetit. Gjatë vitit 2008 ka pasur gjithsej 3 kërkesa për qasje në dokumentet zyrtare. Gjatë dy viteve të kësaj qeverisje nuk ka pasur asnjë petition në adresë të komunës.

Ueb faqja e komunës së Pejës ka gati të gjitha kategoritë që i nevojiten një ueb faqeje zyrtare - disa me më pak informacione e disa më shumë. Është e mirëmbajtur/azhuruar në baza të rregullta kohore (azhurimi i fundit më 28.09.2009). Është e pajisur me informacione të shkëlqyeshme aq sa një qytetari të Pejës do t'i nevojiteshin rreth aktiviteteve të komunës dhe më gjerë. Ballina ka strukturën e duhur të një ueb faqeje zyrtare.

Tab.6. Niveli i përmbajtjes së informacioneve në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Pejës
(www.peja-komuna.org)

Kategoritë e informacioneve	Niveli i informatave ²
Ballina	5
Organizimi komunal	4
Shërbimet komunale	3
Info rreth qytetit	3.63
Projektet komunale	2.5
Lajme& lajmërimë	3.33
Harta e faqes	3
Kontakt	5
Gjuhët	5
Fusha për kërkim	5
Tjera informacione shtesë	2
Baza Ligjore	3
Mesatarja totale	3.70
Renditja në krahasim me ueb faqet e komunave tjera	4

Gjendja në arsim

Gjendja e sektorit të arsimit në komunën e Pejës paraqitet relativisht e njejtë me atë të komunave tjera të Kosovës. Janë bërë disa investime kapitale gjatë këtij mandati dyvjeçar që kanë përmirësuar kushtet për mësim. Janë renovuar shkollat 'Lidhja e Prizrenit' dhe 'Asdreni', kurse në lagjen Dardani është ndërtuar një shkollë e re fillore. Është bërë një avancim në shkollën e muzikës, e cila më herët ka funksionuar si shkollë e ulët, kurse tani kjo shkollë ka edhe nivelin e shkollës së mesme.

Komuna ka edhe një çerdhe publike e cila është e degëzuar edhe në tri qendra tjera. Në Pejë ekzistojnë 42 shkolla fillore së bashku me paralelet e ndara dhe 5 të mesme. Kjo komunë ka edhe shkollën për fëmijë me aftësi të kufizuara apo me nevoja të veçanta, që nuk e ka edhe çdo komuë tjetër. Në sistemin fillor janë gjithësej 16,761 nxënës, ndërsa në atë të mesëm 5,721. Ndërkaq, numri i përgjithshëm i punonjësve arsimor është 1,286, apo thënë ndryshe 1.3 punonjës për 100 banor.

² (rradhitja nga 1 deri 5) 5 - shkëlqyeshëm, 4-shumë mirë, 3-mirë, 2-mjaftueshëm, dhe 1-dobët.

Në Pejë ndodhet edhe fakulteti i Biznesit, që është degë e Universitetit të Prishtinës. Por, studentëve të këtij fakulteti u mungon një konvikt funksional, meqë objekti ekziston por është në gjendje të pabanueshme pasi se nevojitet renovimi. Sidoqoftë, sektori i arsimit ballafaqohet me një problem mjaft të ndjeshëm që u cek edhe më herët e që ka të bëjë me nivelin e ulët të sigurisë nëpër shkolla. Ky problem deomos duhet adresuar më seriozisht nga organet komunale.

Gjendja në shëndetësi

Sektori i shëndetësisë është në një gjendje pak më të volitshme në karahasim me komunat tjera dhe kjo si rezultat i asistencës së madhe financiare nga ana e donatorëve Italian. Spitali rajonal i Pejës ka një reputacion të mirë sa i përket shërbimeve dhe menaxhmentit në përgjithsi. Poashtu, në gjendje të mirë është edhe QKMF-ja. Kjo komunë ka gjithësej 24 QMF dhe punkte shëndetësore, kurse numri i mjekëve është 105. Në sistemin shëndetësor punojnë 372 puntorë, që do të thotë se kjo komunë ka 2.9 punëtorë shëndetësor për 1000 banorë. Megjithatë, edhe në këtë komunë qytetarët ankohen për mungesë të barnave të cilat ata shpesh detyrohet t'i blejnë vet.

Shoqëria civile

Në komunën e Pejës janë të regjistruara një numër mjaft i madhë i OJQ-ve mirëpo vetëm pak nga to janë aktive. Organizatë jo-qeveritare që ka ndërtuar një reputacion mjaft të madhë në komunën e Pejës është "Syri i Vizionit" e cila merret kryesisht me promovimin e demokracisë lokale duke angazhuar qytetarët në debate të ndryshme në lidhje me problemet e përgjithshme të komunës. Po ashtu, kjo organizatë angazhohet edhe në orfrimin e ndihmës në zhvillimin e mediave, promovimin e të drejtave të minoriteteve, përkrahjen për kthimin dhe ri-integrimin e personave të zhvendosur dhe refugjatëve, monitorimin e institucioneve lokale, etj.

Qendra Rinore "At Lorenc Mazreku" është tjetër mjaft aktive në këtë komunë. Kjo organizatë përveç organizimit të aktiviteteve rinore merret edhe me monitorimin e gjithmbarshëm të arsimit fillor dhe të mesëm. Me aktivitete të njëjta është e angazhuar mjaft shumë edhe organizata tjetër rinore "Zoom".

Në kuadër të mbrojtjes së drejtave të femrave, vepron mjaft aktivisht dhe organizata "Shoqata për Mirëqenjen e Gruas" e cila ka implementuar një seri projektesh që kanë pasur si qëllim ngritjen e vetëdijes për respektimin e të drejtave të femrave si dhe mbojejn e femrave nga format e diskriminit dhe trafikimit.

Mediat lokale

Mediat poashtu janë mjaft të involvuara në informimin e qytetarëve rreth problemeve dhe vendimeve që ndërmarrin organet komunale në përgjithsi. Ndër mediat më aktive që veprojnë në komunën e Pejës janë Radio Dukagjini dhe TV Dukagjini që në mënyrë të vazhdueshme monitorojnë zhvillimet në komunë. Radio "Peja" poashtu është një nga mediumet lokale. Ekzistojnë edhe disa radio tjera lokale që u shërbejnë kryesisht minoriteteve si Radio Hajati që emeton programe në gjuhën boshnjake, pastaj Radio Gorazhdeci që transmeton në gjuhën serbe etj.

Rendi dhe ligji në Komunën e Pejës

Nga 1 janari 2008 deri 31 dhjetor 2008, në Komunën e Pejës kanë ndodhur **4707** raste të shkeljes së rendit dhe ligjit, në gjithsejtë **84 shkelje të natyrave të ndryshme**. Shkeljet më të mëdha kanë ndodhur në këto fusha:

Tab.9. Numri i rasteve më të shpeshta të shkeljes së rendit dhe ligjit në Pejë (2008)

Natyra e shkeljes së rendit dhe ligjit	Numri i rasteve të shënuara
Aksidente	-
Prishja e rendit dhe qetësisë publike	40
Pengim i personave zyrtar në kryerjen e punës	48
Vjedhje e pyjeve	159
Incidente lidhur me pronën	318
Vjedhje	1182
Abuzime seksuale	14
Shkaktim të dëmtimeve trupore	177
Kërcënime	209
Mashtrime	78
Vrasje	20
Incidente në baza etnike, religjioze apo racore	1

Në krahasim me komunat tjera, Komuna e Pejës dallohet për nga numri i madh i vjedhjes së pyjeve. Peja renditet e treta (pas Istogut dhe Deçanit) me 159 raste të vjedhjes së pyjeve gjatë vitit 2008. Vjedhja e pyjeve është një ndër problemet më të mëdha të kësaj komune siç është cekur edhe më lartë. Peja gjithashtu renditet e para sa i përket numri të madh të prishjes së rendit dhe qetësisë publike, e dyta për nga numri i incidenteve lidhur me pronën, e treta për nga numri i abuzimeve seksuale dhe e katërta për nga numri i vrasjeve.

Tatimi në pronë

Bazat për vënien e tatimit në pronë në Kosovë ende përlogariten sipas Rregullores së UNMIK-ut 2003/29 për tatimin mbi pronën e paluajtshme në Kosovë. Sipas kësaj rregulloreje, Kuvendi Komunal i çdo komune i cakton tarifat tatimore mbi pronën në bazë vjetore në shkallën prej 0.05 % dhe 1 % të vlerës së pronës në treg. Tarifat e tatimit lëvizin brenda kategorive vijuese të pronës: pronë për banim, pronë komerciale, pronë industriale dhe pronë bujqësore.

Tab.10. Tatimi në pronë në Komunën e Pejës

Zona	Pronë për banim		Prona komerciale	Prona Industriale	Prona bujqësore
	Banesa	Shtëpi			
Norma tatimore					
	0.09%	0.09%	0.15%	0.12%	0.10%

I	420 €	500 €	1200 €	450 €	300 €
II	400 €	450 €	1100 €	400 €	200 €
III	350 €	400 €	800 €	400 €	150 €
IV	250 €	300 €	500 €	300 €	100 €

* Vlera e tregut për metër katror.

Kostoja për biznese

Deri në prill të vitit 2008, në Komunën e Pejës kanë qenë të regjistruara 4317 biznese private. Leja për hapjen e biznesit në këtë komunë ndryshon në bazë të llojit të bizneseve. Tabela më poshtë pasqyron disa nga bizneset më të mëdha dhe më të shpeshta që mund të gjinden në këtë komunë, dhe taksa për leje që ato duhet të paguajnë në Komunën e Pejës.

Tab.9. Llojet e bizneseve dhe taksa vjetore që janë të detyruara të paguajnë për leje të punës

Lloji i biznesit	Taksa vjetore e punës
Bankat	800-1000 €
Kompanitë e sigurimit	500-1,000 €
PTK komunikimi dhe distribucioni	800-1,000 €
KEK	1,000 €
Hotelet	800 €
Motelet	500 €
Supermarketet-Hipermarketet	1,000 €
Vetëshërbimet – Minimarketet	100 - 300 €
Kafeteritë	200 €
Restorantet	100-150 €
Kompanitë “import-export”	500 €
Barnatoret	200 - 300 €
Autoshkollat	200 €
Ndërmarrjet që merren e shitjen e drurit	200-500 €
Universitetet private	1,000 €
Ndërmarrjet ndërtimore	200 - 500
Punëtoritë (argjendaritë, zdrukthtaritë, automekanikët, bukëpjekësit, frizerët, etj.)	50 - 100 €
Pompat e benzines	1,000 €
Agjencitë turisitke	200 €
Veprimtaritë e pavarura profesionale (mjekët, stomatologët, avokaturat, arkitektët, etj.)	200 -300 €